



12 tetor 2008

## MITING I PKSH NË SHESHIN "ÇERIÇIZ TOPULLI" GIROKASTËR

- Merr pjesë Kryetari i PKSH-së Hysni Milloshi-

Në 12 Tetor 2008 ora 10.00 në sheshin "Çeriçiz Topulli" Komiteti i Partisë i PKSH për Gjirokastrë organizoi një miting me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Ishte i pranishëm edhe kryetari i PKSH-së Hysni Milloshi, si dhe anëtarët e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror Kalem Kalemi, Kristaq Mosko, Shahin Çela, Edmond Memushi, Nimete Bahja, Mihal Mitro, Gaqi Popi dhe Harilla Gjoni. Mitingun e hapi anëtari i KQ të Partisë, shoku Eqerem Peçi. Për jetën dhe veprën e Enver Hoxhës foli në miting kryetari i Partisë Komuniste për rrethin shoku Delo Serjani. Në miting foli dhe shoku Hysni Milloshi, fjalimi i të cilit u shoqërua me duartrokitje të shpeshta. Pas mitingut komunistët vizituan shtëpinë ku lindi Enver Hoxha. Në vijim ata u njohën me një ekspozitë fotografike kushtuar Enver Hoxhës, të cilën e prezantoi sekretari i Komitetit të Partisë së rrethit shoku Bujar Sulejmani. Në sallën e ekspozitës u shtrua edhe një koktej. Mitingu i Gjirokastrës u ndoq nga gazetarë lokalë dhe të qendrës. Të nesërmen, më 13 tetor, gazeta "Panorama" ka dizinformuar poshtërsisht lidhur m këtë miting. S'ka patur asnjë incident midis Hysni Milloshit dhe djalit të Enver Hoxhës. Ilir Hoxha s'ka qenë fare atë ditë në Gjirokastrë, por të nesërmen, i shoqëruar nga miq e shokë të vet. Ku për çudi nuk është lejuar të vizitonte shtëpinë e babait të tij. Poshtërsi të tilla në Shqipëri tashmë janë të njohura. Fjalimi i Hysni Milloshit mbajtur më 12 Tetor në Gjirokastrë do të botohet në numrat e ardhshëm të gazetës.